VENDIM
Nr. 395, datë 29.4.2015

PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT KOMBËTAR TË PRAKTIKAVE TË PUNËS NË ADMINISTRATËN SHTETËRORE DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE[1]

(Ndryshuar me VKM nr.835, datë 23.11.2016; nr.277, datë 16.5.2018)

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 100, të Kushtetutës, me propozimin e *ministrit përgjegjës për rininë*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe institucionet e tjera publike për profesionistë të rinj (në vijim referuar si "Programi Kombëtar i Praktikave të Punës").

2. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës synon të përfshijë pjesëmarrësit në një eksperiencë pune të integruar e në ndërveprim me profesionistë karriere në administratën publike, me qëllim përfitimin e një përvoje kualifikuese që ndikon në zhvillimin e aftësive të tyre profesionale e të shprehive të tyre praktike në njohje me sistemin administrativ publik.

3. Aplikantët, të cilët do të bëhen pjesë e këtij programi, duhet të jenë të rinj nga mosha 21 deri në 26 vjeç, të diplomuar në programet e studimit të ciklit të parë "Bachelor".

4. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës zgjat nga 3 muaj deri në 12 muaj, sipas thirrjeve. Përfshirja në këtë program është pa pagesë. Periudha e praktikës së zhvilluar do të njihet si përvojë pune gjatë procedurave të rekrutimit në institucionet e administratës publike.

5. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet nga *ministria përgjegjëse për rininë*, e cila do të mbështetet nga institucionet e administratës shtetërore dhe institucione të tjera publike që ofrojnë gatishmëri për pranimin e aplikantëve. *ministria përgjegjëse për rininë* do të kryejë rolin e sekretariatit teknik të programit për koordinimin ndërinstitucional.

6. Programi Kombëtar i Praktikave të Punës do të realizohet sipas planveprimit dhe metodologjisë së miratuar nga ministri përgjegjës për rininë, që përcakton shpalljen për thirrjet e radhës, afatin për aplikim, dokumentet për aplikim dhe mënyrën e vlerësimit.

7. Administrata shtetërore dhe institucionet e tjera publike që mbështetin këtë program duhet të paraqesin numrin e praktikantëve dhe profilin e tyre. Të gjitha institucionet pjesëmarrëse në këtë program kanë për detyrë të përcaktojnë 1 person kontakti i cili është përgjegjës për:

a) Dorëzimin pranë ministrisë përgjegjëse për rininë e Departamentit të Administratës Publike të numrit të praktikantëve për çdo thirrje;

b) ofrimin e kushteve të nevojshme të punës;

c) përcaktimin e një mbikëqyrësi për çdo praktikant;

ç) komunikimin me *ministrinë përgjegjëse për rininë*;

d) Dërgon pranë Departamentit të Administratës Publike emrat e praktikantëve që rezultojnë fitues të procesit të përzgjedhjes për çdo thirrje, brenda 5 (pesë) ditëve pune nga data e përfundimit të këtij procesi.

Në përfundim të programit, institucioni i lëshon praktikantit vërtetimin për kryerjen e praktikës.

8. Mbikëqyrësi në administratën shtetërore duhet të jetë i konfirmuar me statusin e nëpunësit civil. Në institucionet e tjera publike ai duhet të jetë një punonjës me eksperiencë në punën që kryen.

9. Mbikëqyrësi ka përgjegjësinë:

---

[1] VKM nr. 395, datë 29.4.2015 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.80, datë 21 maj 2015.
VKM nr.835, datë 23.11.2016 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.239, datë 13 dhjetor 2016.
VKM nr.277, datë 16.5.2018 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.80, datë 30 maj 2018.

a) të përcaktojë detyrat dhe angazhimet për praktikantin;

b)të supervizojë, të këshillojë dhe të udhëzojë gjatë realizimit të detyrave të dhëna;

c) të vlerësojë performancën e praktikantit gjatë praktikës;

ç) të përpilojë vërtetimin në të cilin përcaktohen kryerja e praktikës,

njësia pranë së cilës është realizuar praktika dhe përshkrimi i detyrave;

d) të përgatitë vlerësimin përfundimtar për praktikantin;

dh) të gjykojë për arsyet e përfundimit të programit nga ana e praktikantit në rast shkeljeje të marrëveshjes midis institucionit dhe praktikantit.

10. Thirja e parë e Programit Kombëtar të Praktikave të Punës do të kryhet brenda muajit qershor 2015.

11. Institucionet e administratës shtetërore qendrore, pjesëmarrëse në program, do të punësojnë me kontratë të përkohshme pune 200 praktikantë, të përzgjedhur nga thirrja e parë dhe që kanë kryer praktikën e punës në atë institucion në kuadër të kësaj thirrjeje. Përzgjedhja e praktikantëve kryhet nga secili institucion pjesëmarrës mbi bazën e vlerësimit të performancës, mesatares dhe titullit të studimit që përkon me profilin e pozicionit të punës. Numri i praktikantëve që do të mund të punësohen në thirrjet në vazhdim do të përcaktohet rast pas rasti.

11/1. Ministria përgjegjëse për rininë administron procesin e punësimit të praktikantëve në thirrjet e radhës, për çdo institucion të administratës shtetërore, deri në 200 praktikantë në çdo vit buxhetor, bazuar në kërkesat e institucioneve për punësimin e praktikantëve për 1 (një) vit kalendarik dhe numrin e praktikantëve që kanë kryer me sukses programin kombëtar të praktikave të punës.

11/2. Ministria përgjegjëse për rininë dërgon në ministrinë përgjegjëse për financat numrin e praktikantëve që do të punësohen në çdo institucion të administratës shtetërore, në kuadër të programit kombëtar të praktikave të punës për çdo vit buxhetor. Ministria përgjegjëse për financat njofton degët e thesarit për numrin e praktikantëve që do të paguhen brenda fondeve të miratuara për institucionin përkatës në ligjin vjetor të buxhetit.

12. Në përfundim të çdo programi, *ministria përgjegjëse për rininë* i raporton Departamentit të Administratës Publike për çdo praktikant për periudhën profesionale si dhe institucionit, pranë të cilit është kryer kjo praktikë. Këto të dhëna regjistrohen nga Departamenti i Administratës Publike në një bazë të posaçme të dhënash.

13. Praktikantët e punësuar, për efekt pagese, klasifikohen jo më lart se niveli i specialistit të kategorisë IV-b. Fondet e nevojshme financiare për zbatimin e pikave 11/1 dhe 11/2, të këtij vendimi, përballohen nga fondet e buxhetit të miratuara për institucionet e administratës shtetërore për shpenzimet e personelit, për vitin përkatës..

14. Ngarkohen *ministria përgjegjëse për rininë*, Ministria e Financave dhe të gjitha institucionet e administratës publike, të përfshira në program, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama